



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.33

Prishtinë, më 11.11.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N 302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Srdjan Popović, Shpejtim Bulliqi dhe Mufera Sinik.

Munguan: Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyqi

Pjesëmarrës të tjerë: Sevdai Radogoshi aktor, përfaqësues të KDI- së dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dt. 01.11.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Kinematografinë;
4. Të ndryshme.

Në fillim të mbledhjes me ftesë të Kryetarit të Komisionit në mbledhje mori pjesë aktori i mirënjohur Sevdai Radogoshi.

Kryetari i Komisionit foli për kontributin e dhënë prej dekadash të aktorit Sevdai Radogoshi i cili kontribut i dhënë prej shumë kohësh është përcjellë në shumë gjenerata.

Anëtarët tjerë të Komisionit vlerësuan kontributin e dhënë të aktorit të mirënjohur dhe thanë sesuksesi i tij së fundmi është vlerësuar edhe me mirënjohje dhe çmim ndërkombëtar për film të metrazhit të shkurtër.

Sevdai Radogoshi tha se ndjehet i privilegjuar për ftesën e Komisionit dhe se çmimin e marrë para disa ditëve në Hollyvud ia dedikon vendit të tij.

Me këtë rast aktorit Radogoshi iu dorëzua një dhuratë simbolike nga ana e Komisionit.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 09.11.2015

Procesverbali i mbledhjes së dates 09.11.2015 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kinematografinë;

Komisioni, vazhdoi me shqyrtimin dhe amendamentimin nen për nen të Projektligjit, njëkohësisht duke shqyrtuar dhe analizuar vërejtjet dhe sugjerimet e propozuara me shkrim nga grupet e interesit dhe komuniteti artistik.

Anëtarët e Komisionit vazhduan me shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjit nga neni 27 me këtë rast u propozuan disa amendamente të cilat priten të rishshqyrtohen dhe riformulohen në mbledhjen e radhës.

Anëtarët e Komisionit propozuan që në mbledhjen e radhës të ftohet ministri i Kulturës z. Kujtim Shala në mënyrë që të sqarohen disa nga nenet të cilat Komisioni vlerëson se duhet ndryshuar.

4. Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

Përgatitur nga: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani